



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
ADMINISTRATORI

Nr. 2094 / Prot.  
5

Tiranë, më 25/8 / 2022

**FTESË PËR TENDER**

Nr. 72 / 2, Datë 25.08.2022

Për

**“Krijim dhe blerje pakete software “University Management Software”**

Projekt i financuar në kuadër të Programit të BE Erasmus+ “STAND”

**DREJTUAR: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIK TË INTERESUAR PËR TË MARRË PJESË**

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës

Referimi ynë: Urdhër blerje nr.72, datë 25.08.2022

Subjekti: Ftesë për ofertë me objekt **“Krijim dhe blerje pakete software - University Management Software”**

Të nderuar Zonja / Zotërinj,

Rektorati i Universitetit të Tiranës, në zbatim të projektit të financuar në kuadër të Programit të BE IPA II “Erasmus+”, bazuar në Partnership Agreement me Kordinatorin Lider “Business College Mitrovica” për projektin “Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkan Universities” – me akronim (STAND) me nr.ref: 618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP, në parashikimet e udhëzuesit sipas versionit të fundit “Guidelines for the use of the grant CBHE 2021”, në vijim të kërkesës me shkresën nr.2094/1, datë 21.07.2022, si dhe në Urdhërin e blerjes nr.prot.2094/3, datë 25.08.2022, Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt “Krijim dhe blerje pakete software - University Management Software” sipas preventivit të mëposhtëm dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Nr.	Emërtimi i mallit, specifikimet teknike bashkëlidhur / Description, Technical specifications required attached	Njësia	Sasia (shifra)	Sasia (shkrim)
A	<i>Krijim dhe blerje pakete software me titull - University Management Software, e ndarë në 3 module/zëra:</i>			
1	Modul i Sigurimit të Cilësisë	copë	1	një
2	Moduli për menaxhimin dhe Vlerësimin e Projekteve	copë	1	një
3	Moduli për menaxhimin e dokumenteve	copë	1	një
4	Shërbim Trajnimi në 10 ditë	shërbim	1	një
5	Shërbim Mirëmbajtje	muaj	12	dymbëdhjetë

**Buxheti/Budget:**

Fondi limit i parashikuar është **33,040.00 (tridhjetë e tremijë e dyzet) Euro pa tvsh.**

Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë oferta financiare nën këtë buxhet maksimal.

**Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës/ Place and date of bid submission:**

Aplikimet duhet të dorëzohen ekskluzivisht në autoritetin kontraktor në protokoll, në një zarf të mbyllur të vulosur dhe firmosur, në adresën:

Universiteti i Tiranës

Address: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave do të jetë data **07.09.2022, deri në ora 14:00 am.**

**Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:**

Tenderuesit duhet të vërtetojnë se nuk janë në një nga situatat e renditura më poshtë duke plotësuar deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ligjore bashkëlidhur kësaj ftese.

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale,

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

e) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- *Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.*

- *Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

**Kriteret e përzgjedhjes/Selection criteria:**

Operatorët ekonomik **duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur pranë autoritetit kontraktor me protokoll, jo me vonë se data dhe ora e caktuar**, plotësimin e dokumentave si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

1. Formularin e ofertës ekonomike, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur.
2. Deklaratë mbi konfliktin e interesit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.
3. Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ligjore, sipas shtojcës 3 bashkëlidhur.
4. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur.

5. Ekstrakti mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, i cili duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit, lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
6. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me vlerë jo më pak se fondi limit.
7. Furnizime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, vërtetuar nëpërmjet Faturave tatimore të shitjes me subjektet private ose vërtetime realizim kontratash me subjektet publike, ku totali i tyre të jetë me vlerë jo më të vogël se fondit limit.
8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit:
  - ISO 9001:2015 (ose ekuivalente), lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë.
  - ISO 20000-1:2011 (ose ekuivalente), lidhur me Sistemin e Menaxhimit të Shërbimit.
  - ISO 27001:2013 (ose ekuivalente), lidhur me Sistemin për Sigurinë e Informacionit.
9. Operatori ekonomik për realizimin e objektit të kontratës, duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 4 (katër)** persona të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike/ ose Inxhinieri Informatike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/ Informatikë Matematikë/ Inxhinieri Matematike dhe Informatike/ Informatikë Ekonomike/ Telekomunikacion/ Inxhinieri Telekomunikacion ose ekuivalente, të certifikuar me këto kompetenca:
  - a) 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti ose ekuivalente.
  - b) 1 (një) punonjës të certifikuar për "ITIL Foundation" ose ekuivalente..
  - c) 2 (dy) punonjës të certifikuar si Microsoft Specialist në Programming HTML5 me Java Script dhe CSS3 ose ekuivalente.
  - d) 1 (një) punonjës për Administrim të Windows Server ose ekuivalente.

*Disponimi i punonjësve do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme:*

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diploma e shoqeruar me çertifikatat e kualifikimit apo transkriptet përkatëse të kërkuara më sipër, të lëshuar nga institucione kombëtare/ndërkombëtare të licensuara/akredituara nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalent. Çertifikatat duhet të jenë të verifikueshme ose të paraqiten kontakte të vlefshme në rast nevojë për verifikim.
- si dhe të figurojë në Listpagesat e subjektit për 3 muajt e fundit.
- Një punonjës, mund të ketë një ose disa çertifikime.

**Dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre e të përkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Kriteri i vlerësimit /Award criteria:**

Oferta fituese do të bazohet në parimin e ofertës me çmimin më të ulët.

- Oferta duhet të plotësojë kërkesat minimale teknike dhe sasiore. Oferta fituese do të bazohet në parimin e çmimit më të ulët të ofertës së përgjegjshme.
- Ku nevojiten jo më pak se 3 oferta të vlefshme nga 3 operatorë të ndryshëm.

**Afati i realizimit të furnizimit do të jetë brenda 15 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.**

**Nënkontraktimi / outsourcing:**

Nënkontraktimi është i lejuar.

**Vlefshmëria e tenderit / Tender validity:**

Tenderi është i vlefshëm për një periudhë prej 3 muajsh pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Në rrethana të jashtëzakonshme, autoriteti kontraktor mund, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, të kërkojë që tenderuesit të zgjasin vlefshmërinë e ofertave për një periudhë specifike.

**Gjuha e tenderit / Tender language:**

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip ose anglisht. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe ose angleze. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

Draft Formulari i kontratës është bashkëlidhur.

**ADMINISTRATORI  
SKERDI DAFA**



**SPECIFIKIME TEKNIKE DHE SASIA / TECHNICAL SPECIFICATIONS REQUIRED AND QUANTITY**

Reference: “Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkan Universities” – (STAND) me nr.: 618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP

Objekti: **Krijim dhe blerje pakete software me titull - University Management Software**

Nr.	Emërtimi i mallit / Description	Njësia	Sasia (shifra)	Sasia (shkrim)
A	<i>Krijim dhe blerje pakete software - University Management Software, e ndarë në 3 module/zëra:</i>			
1	Modul i Sigurimit të Cilësisë	copë	1	një
2	Moduli për menaxhimin dhe Vlerësimin e Projekteve	copë	1	një
3	Moduli për menaxhimin e dokumenteve	copë	1	një
4	Shërbim Trajnimi në 10 ditë	shërbim	1	një
5	Shërbim Mirëmbajtje	muaj	12	dymbëdhjetë

Gjenden bashkëlidhur specifikimet teknike të detajuara / Technical specifications required attached.

**Shtojca 1**

[ Shtojca për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

Datë 07.09.2022

**FORMULARI I OFERTËS**

Emri i Ofertuesit : \_\_\_\_\_

**Për: Rektoratin e Universitetit të Tiranës**

**projekti “STAND” me nr.ref: 618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Krijim dhe blerje pakete software - University Management Software”**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është \_\_\_\_\_ (vlera në shifra dhe fjalë) Euro pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është \_\_\_\_\_ (vlera në shifra dhe fjalë) Euro me TVSH.

Nr.	Emërtimi i mallit/Description	Njësi	Sasia	Çmimi (Euro)	Vlera (Euro)
A	<i>Krijim dhe blerje pakete software me titull - University Management Software, e ndarë në 3 module/zëra:</i>				
1	Modul i Sigurimit të Cilësisë	copë	1		
2	Moduli për menaxhimin dhe Vlerësimin e Projekteve	copë	1		
3	Moduli për menaxhimin e dokumenteve	copë	1		
4	Shërbim Trajnimi në 10 ditë	shërbim	1		
5	Shërbim Mirëmbajtje	muaj	12		
<b>Shuma pa Tvsh</b>					
<b>TVSH (20%)</b>					
<b>Vlera Total</b>					

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula:**

*Shënim:*

Të dhënat financiare që do të sigurohen nga Tenderuesi/Kandidati në formularin e ofertës duhet të shprehen në Euro. Nëse Tenderuesi/Kandidati i referohet shumave të shprehura fillimisht në një valutë tjetër (lek), konvertimi në Euro do të bëhet në përputhje me kursin e këmbimit InforEuro të së cilës mund të gjendet në adresën vijuese:

<http://ec.europa.eu/budget/graphs/inforeuro.html>.

## Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e tenderimit që do të zhvillohet në datë **07.09.2022** nga Autoriteti Kontraktor “**Universiteti i Tiranës**” me objekt “**Krijim dhe blerje pakete software “University Management Software”** me fond limit **33.040,00 euro pa tvsh**.

Në cilësinë e operatorit ekonomik “\_\_\_\_\_” shpk, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive.

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Data e dorëzimit të deklaratës: \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula**

\_\_\_\_\_

### Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

## DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME LIGJORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e tenderimit që do të zhvillohet në datë **07.09.2022** nga Autoriteti Kontraktor “**Universiteti i Tiranës**” me objekt “**Krijim dhe blerje pakete software “University Management Software”** me fond limit **33.040,00 euro pa tvsh**.

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.**

Data e dorëzimit të deklaratës: \_\_\_\_\_

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula:

\_\_\_\_\_



*Shtojca 4*

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e tenderimit që do të zhvillohet në datë **07.09.2022** nga Autoriteti Kontraktor **“Universiteti i Tiranës”** me objekt **“Krijim dhe blerje pakete software “University Management Software”** me fond limit **33.040,00 euro pa tvsh**, për projektin **“STAND”** me nr.ref: **618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP**.

Unë, i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_, deklaroj se:

Marrim përsipër të përmbushim të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Data e dorëzimit të deklaratës:** \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula:**

\_\_\_\_\_

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**DRAFT FORMULARI I KONTRATËS**  
**KONTRATË FURNIZIMI**

**OBJEKTI: “Krijim dhe blerje pakete software “University Management Software”**

Projekti “Erasmus +”

“me nr.ref.: 618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP”,

“Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkan Universities” – (STAND)

**NENI 1**

**PALET**

1. Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I TIRANËS, përfaqësuar nga Administratori, Z. Skerdi DAFA, me adresë Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, me Nipt J61915033D.
2. Kontraktuesi: “\_\_\_\_\_” shpk, me administrator Z. \_\_\_\_\_, me adresë \_\_\_\_\_, me NIPT \_\_\_\_\_.

**NENI 2**

**TERMAT E KËSAJ MARRËVESHJE:**

1. Me “Autoritet Kontraktor” do të kuptohet Universiteti i Tiranës.
2. Me “Kontraktues” do të kuptohet pala që merr përsipër të kryejë furnizimin për Autoritetin Kontraktor.
3. Me “furnizim” do të kuptohet furnizimi me software për UT.
4. Me “Çmim” do të kuptohet shpërblimi që do të marrë i Kontraktuesi duke përfshirë këtu të gjitha detyrimet fiskale në fuqi, sipas objektit bazuar në Urdhrin e Blerjes nr.72, datë 25.08.2022 dhe Ftesën për Ofertë nr.72/2, datë 25.08.2022.

**NENI 3**

**OBJEKTI**

1. Objekti i kësaj marrëveshje është furnizimi me software, për Universitetin e Tiranës, si më poshtë, dhe sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur:

Nr.	Emërtimi i mallit/Description	Njësi	Sasia	Çmimi € pa tvsh	Vlera € pa tvsh
A	<i>Krijim dhe blerje pakete software me titull - University Management Software, e ndarë në 3 module/zëra:</i>				
1	Modul i Sigurimit të Cilësisë	copë	1		
2	Moduli për menaxhimin dhe Vlerësimin e Projekteve	copë	1		
3	Moduli për menaxhimin e dokumenteve	copë	1		
4	Shërbim Trajnimi në 10 ditë	shërbim	1		
5	Shërbim Mirëmbajtje	muaj	12		
<b>Shuma pa TVSh</b>					
<b>TVSh (20%)</b>					
<b>Vlera Total</b>					

2. Nga ana e tij Kontraktuesi merr përsipër të ofrojë këtë furnizimin ndaj Autoritetit Kontraktor, kundrejt një çmimi të caktuar duke i garantuar atij besnikëri dhe korrektësi në kryerjen e lëvrimin, sipas specifikimeve teknike të Aneksit nr.2 bashkëlidhur.

#### NENI 4

##### AFATI

1. Afati i kryerjes së furnizimit do të jetë brenda **15 muajve** nga nënshkrimi i marrëveshjes së furnizimit. Me pëlqimin e të dyja palëve kjo marrëveshje mund të zgjatet edhe tej këtij afati nëpërmjet një kërkesë argumentimi.
2. Nëse palët do të mendojnë të zgjidhin marrëveshjen duhet të lajmërojnë njëra - tjetrën të paktën 2 ditë para.

#### NENI 5

##### ÇMIMI DHE MËNYRAT E PAGESËS

1. Furnizimi i përcaktuar në objektin e kësaj kontrate do të ketë një vlerë të pergjithshme prej \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) euro me tvsh.
2. Nuk zbatohen pagesa paraprake.
3. Pagesa do të kryhet në këtë mënyrë: Pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që lindin nga kjo kontratë, shoqëruar me:
  - a. Faturën origjinale tatimore të shitjes së Furnizuesit, që tregon përshkrimin e mallrave, sasinë, çmimin për njësi dhe shumën totale;
  - b. Proces-verbalin e marrjes në dorëzim të mallit.
  - c. Fletë-hyrjen e mallrave.
4. Pagesa do të kryhet në Bankën \_\_\_\_\_, në llogarinë bankare nr. \_\_\_\_\_, me IBAN \_\_\_\_\_, që Kontraktuesi ka vënë në dispozicion të AK.

#### NENI 6

##### SIGURIMI I KONTRATËS DHE GARANCIA

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Kontratës në shumën prej (10% të çmimit të kontratës) për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit me përfundimin e plotë të kontratës.
2. Garancia: Mallrat e ofruar duhet të mbulohen për periudhën e mirëmbajtjes së sistemit, duke nisur nga data e lëvrimin në AK, jo më pak se 12 muaj.

#### NENI 7

##### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë korrektësi dhe përmbushje të detyrave brenda afateve të caktuara nga palët në këtë kontratë.
2. Autoriteti Kontraktor detyrohet të paguajë vlerën e furnizimit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj kontrate pa qënë nevoja e lajmërimit më përpara nga Kontraktuesi.
3. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë informacion të plotë mbi të gjitha detyrat që i kërkojnë.
4. Kontraktuesi ka të drejtë të kërkojë vlerën e furnizimit të përcaktuar në nenin 5 të kësaj kontrate.
5. Kontraktuesi detyrohet të kryejë me besnikëri dhe korrektësi të gjitha detyrat e përcaktuara në nenin 3 të kësaj kontrate duke iu përmbajtur afateve të përcaktuara.
6. Kontraktuesi detyrohet të përmbushë specifikimet teknike të kërkuara.

#### NENI 8

##### NËNKONTRAKTIMI

1. Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrëveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.
2. Kontraktuesi nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nën kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

3. Çdo nënkontraktor ka të drejtë të marrë pjesë në prokurim publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për mallrat që do të furnizojë.
4. Kontraktuesi mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

#### **NENI 9**

##### **RUAJTJA E SEKRETIT**

1. Të dyja palët angazhohen në ruajtjen e sekretit profesional për probleme të cilat kanë lidhje me objektin e kësaj marrëveshje. Të dyja palët angazhohen të respektojnë njëri-tjetrin maksimalisht dhe të përmbushin detyrat e marra përsipër.

#### **NENI 10**

##### **FORCAT MADHORE**

1. Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për penalitete ose ndërprerje kontrate për mos përmbushje të furnizimit në qoftë se kjo vonese në performancën ose mospërmbushje e detyrimeve sipas Kontratës vjen si rezultat i një ngjarje që është Forcë Madhore dhe deri në masën që ajo e shkakton mospërmbushjen.
2. Për qëllimet e kësaj klauzole, "Force Madhore" do të thotë një ngjarje përtej kontrollit të Kontraktuesit dhe që nuk përfshin fajin e Furnizuesit apo neglizhencën dhe që është e paparashikueshme. Këto ngjarje mund të përfshihen por mund të mos kufizohen vetëm me një akt të AK ne kapacitetin e tij sovran, luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë, kufizimet e karantinës, dhe embargo te ngarkesës.
3. Në qofte se lind situata e një Force Madhore, Kontraktuesi do të njoftojë menjëherë AK me shkrim për këto kushte dhe shkakun që e ka sjelle atë. Vetëm në qoftë se udhëzohet ndryshe nga AK me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë të kryejë detyrimet e tij sipas Kontratës për aq sa është praktike në mënyre të arsyeshme, dhe do të kërkojë të gjitha mjetet alternative të arsyeshme për performancën të pa pengua nga ngjarja e Forcës Madhore.

#### **NENI 11**

##### **ZGJIDHJA E KONTRATËS**

1. Kontrata përfundon me mbarimin e afatit të përcaktuar.
2. Kontrata mund të zgjidhet edhe para mbarimit të këtij afati me pëlqimin e të dyja palëve pasi të kenë ezauruar detyrimet reciproke.
3. Kontrata mund të zgjidhet nga secila palë duke lajmëruar të paktën 2 ditë para.
4. Kontrata mund të zgjidhet nga Autoriteti Kontraktor nëse Kontraktuesi nuk përmbush detyrimet e percaktuara ne nenin 1, 3, 4, 6, 7 dhe 9.

#### **NENI 12**

##### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

1. Çdo interpretim i termave do të merret në favor të dyja palëve dhe në kuptimin e përdorshëm të tyre në standardet normale.
2. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe angleze, në 4 (katër) kopje.

**Autoriteti Kontraktor**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**Administratori**  
**Skerdi DAFA**

**Kontraktuesi**  
 “ \_\_\_\_\_ ” shpk  
**Administratori**  
 \_\_\_\_\_